

Politizimi i arsimit dhe kulturës nëpërmjet medias në Qarkun e Elbasanit në vitet '60.

*Elvin Elezi**

Abstrakt

Gazeta “Mësuesi” si organ zyrtar i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës që nga botimet e saj të para, krahas tematikave të tjera ka vënë në fokus edhe pasqyrimin dhe njëkohësisht imponimin e ideologjisë shtetërore të kohës komuniste në institucionet arsimore dhe kulturore në vend.

Ideologji kjo që vinte nga vetë kreu i shtetit, Enver Hoxha, i cili në fjalimin për miratimin e reformës në arsim deklaronte, se: *Ne e bëjmë reformën arsimore sepse është e domosdoshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Ajo do të shërbejë për edukimin dhe përgatitjen më të mirë të rinisë për jetën dhe për detyrat e ndërtimit të shoqërisë socialiste dhe komuniste, i cituar në gazetën “Mësuesi” të datës 9 shkurt 1962.*

Pjesë e këtij tipari të përgjithshëm të jetës në vend ishin edhe institucionet arsimore e ato kulturore të Qarkut të Elbasanit.

Në këtë periudhë vihej theksi se detyra aktuale ishte propaganda politike në shkolla dhe institucione kulturore (vatra dhe shtëpi kulture), duke përdorur edhe media të tjera si, “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi” që ishin gazeta zyrtare të Partisë së Punës dhe mashave të saj, të paktën kështu referohet në të përjavshmen “Mësuesi” të viteve '60.

Në këtë mënyrë një media përveçse përhap linjën e saj editoriale, gjithashtu në të njëjtën kohë sugjeron edhe për media të tjera të së njëjtës linjë në mos më radikale.

Fjalë kyçe: *politizimi, komunizmi, media, arsimit, kultura*

Hyrje

Zhvillimi i arsimit dhe kulturës është çështje thelbësore për shoqërinë njerëzore në tërësi dhe aq më tepër për të ashtuquajturit kombet e vegjël në veçanti. Por në këtë punim do të shqyrtohet çështja e arsimit

* *Elvin Elezi, Doktorant, Departamenti i Historisë, Shkolla e Mesme “Sami Frashëri”, elvin.elezi@yahoo.it*

dhe kulturës në Qarkun e Elbasanit në vitet '60 nën këndvështrimin e politizimit të tyre, edhe nëpërmjet medias së shkruar dhe konkretisht gazetës "Mësuesi" e cila duhej të përfaqësonte zërin e gjithë arsimtarëve dhe punonjësve të kulturës në vend, ose të paktën këtë pretendonte. Siç e theksuam objekti i analizës janë vetëm ato shkrime në gazetën "Mësuesi" si organ zyrtar i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës që lidhen drejtpërdrejt me aspektet e politizimit. Politizimi në arsim dhe kulturë në vitet '60 ishte çështje e ditës në të gjithë vendin, por në këtë punim do t'u referohemi atyre të dhënave e fakteve që lidhen me Qarkun e Elbasanit, ku korrespondentë të gazetës, drejtorë shkollash, mësues, dhe pjesë e administratës së Seksionit të Arsimit të Qarkut, shkruajnë për çështjet e arsimit dhe kulturës nën dritën e politizimit dhe paraqitjen e tij si vlerë që duhet të përfaqësohet nga të gjithë arsimtarët dhe punonjësit e kulturës në të gjithë vendin. Dhe jo vetëm kaq, por frymën politike ta bëjnë pjesë të punës së tyre në institucionet arsimore dhe kulturore në të cilat ata janë të punësuar.

Institucionet arsimore dhe kulturore në Qarkun e Elbasanit në vitet '60 ashtu si në të gjithë vendin drejtoheshin nga Seksioni i Arsimit të Qarkut, i cili nga ana e tij zbaton urdhrat dhe i jep llogari Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës. Pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990 Shqipëria ishte nën regjimin komunist, pra është lehtësisht e kuptueshme që në vitet '60 vendi drejtohej nga Partia Komuniste (edhe pse tanimë quhej Partia e Punës) që përndryshe do të thotë që binomi udhëheqës është parti-shtet.

Si rrjedhojë politikat në çdo fushë të jetës përfshi dhe ato të arsimit dhe kulturës drejtoheshin nga partia e vetme në vend. Kjo dëshmohet edhe nga llogaridhënia që kanë drejtuesit e institucioneve arsimore dhe kulturore. Këta drejtues fillimisht i informojnë mbi punën e tyre institucionet rajonale të partisë e më pas institucionin e Seksionit të Arsimit ndaj të cilit janë vartës ligjërisht, siç na paraqitet në një nga artikujt e vitit 1961 në të përjavshmen "Mësuesi" ku drejtorit të shkollës 7-vjeçare të mbrëmjes në qytetin e Elbasanit, Xhafer Shehu, i është kërkuar të paraqesë një statistikë mbi planet e shkollës dhe

raportin midis frekuentimit real të nxënësve në shkollë dhe numrit të përgjithshëm të regjistruar të tyre.¹

Në institucionet kulturore gjithashtu të politizuara na jepet panorama e veprimtarisë dhe e çështjeve të ditës në aspektin e politizimit. Ku çështja politike e ditës në pranverën e vitit 1963 ishte e drejtuar në *grisjen e maskës së imperializmit amerikan, kundër ideologjisë borgjeze, për demaskimin e revizionizmit modern dhe sidomos atij jugosllav.*²

Kjo veprimtari politike shtrihet njëkohësisht në institucionet kulturore (vatra e shtëpi kulture) dhe në shkolla duke i emërtuar ato si *qendrat e agjitacionit.*³

Në të cilat veprimtaria politike përmbushet duke marrë edhe media të tjera të shkruara të vendit: *janë afishuar numrat e organeve kryesore të shtypit tonë, si gazeta "Zëri i popullit" dhe "Bashkimi"*⁴ të cilat ishin media zyrtare dhe kryesore të shkruara të Partisë së Punës dhe mashave të saj.

Në këtë mënyrë gazeta "Mësuesi" përveçse përçon linjën e saj të politizuar, në të njëjtën kohë sugjeron edhe mediet zyrtare të partisë-shtet si pjesë e veprimtarisë politike në institucionet arsimore dhe ato kulturore në qarkun e Elbasanit.

Dhe kjo veprimtari politike kryhej nga mësuesit, në këtë artikull thuhej kryesisht nga mësuesit e fshatit të rrethit tonë, (E.E-Elbasanit) ku përmenden arsimtarët e një sërë shkollave si: *Shtëpajt, Kuqanit, Bradasheshit, Shushicës, Gjergjanit, Shtërmenit, Shalësit, Belshit, Gjocajt, Pajovës, etj.*⁵

Politizimi i arsimit në vend ishte direktivë e udhëheqësit të shtetit, ku çështjen e arsimit e vendoste në kuadrin e reformës arsimore në themel të së cilës do të ishte ndërtimi i një shoqërie ideologjike që nga bankat e shkollës dhe gjatë gjithë jetës. *Ne e bëjmë reformën arsimore-thoshte Enver Hoxha në plenumin e Komitetit Qendror të Partisë*

¹ Korrespondenti i gazetës "Mësuesi", "Më shumë kujdes për shkollat e natës", Mësuesi, 8 dhjetor, 1961:3

² Sulë Dedej (Inspektor i seksionit të arsimit e kulturës - Elbasan), "Puna politike e institucioneve kulturore", Mësuesi, 19 prill, 1963:3

³ Ibid.

⁴ Ibid.

⁵ Ibid.

*Punës–sepse ajo është e domosdoshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, ajo do të shërbejë për edukimin dhe përgatitjen më të mirë të rinisë për jetën dhe detyrat e ndërtimit të shoqërisë socialiste e komuniste.*⁶

Kjo reformë arsimore që në përmbajtje të saj kishte edhe politizimin e arsimit do të zbatohet në të gjithë vendin, natyrisht edhe në Qarkun e Elbasanit në vitet '60.

Edhe në ligjin mbi organizimin e sistemit arsimor në Republikën Popullore të Shqipërisë, në nenin 1 të tij, konfirmohet linja e politikave të arsimit të udhëheqësit të shtetit, kur thuhej që sistemi arsimor ka si qëllim edukimin e brezit të ri që t'i përgatisë ata për ndërtimin e shoqërisë socialiste të kohës, me njohuritë të theksuara ideologjike, që të formojë *botëkuptimin marksist-leninist*.⁷

Në shkollat e qarkut të Elbasanit në vitin 1963, konkretisht në shkollën 7 vjeçare "Ptoleme Xhuvani" Elbasan, pas gjithë trysnisë, presionit dhe urdhëresave për politizimin e sistemit arsimor, arsimtarët ishin të detyruar që në çdo lëndë mësimore pa përjashtim të futnin elemente të politizimit, ku përjashtim nuk bënin as shkencat ekzakte si aritmetika dhe aq më tepër në klasat fillore, ku u jepeshin nxënësve ushtrime dhe problema që të pasqyronin qoftë edhe në një fjalë ose formulim të vetëm realitetin socialist të vendit, si ushtrimi matematikor i mëposhtëm: *Kl. IV. a) Një punëtor i dalluar merr 8000 lekë në muaj. $\frac{4}{5}$ të kësaj shume i shpenzon për ushqim, veshje, etj. Sa lekë kursen në muaj?*⁸

Gjithashtu institucionet shkollore janë nën drejtimin e strukturave lokale të partisë, siç konstatohet për shkollën pedagogjike "Luigj Gurakuqi" në qytetin e Elbasanit në dhjetor 1963, e cila ka vendosur që për çdo të diel, mësues dhe nxënës të saj të zhvillojnë në fshatin

⁶ Mësuesi, "Raport i zëvendëskryetarit të parë të Këshillit të Ministrave e Ministrisë të Arsimit dhe Kulturës, deputetit Manush Myftiu", Mësuesi, 14 qershor, 1963:1.

⁷ Sami Baholli, "Ligj mbi organizimin e sistemit arsimor në Republikën Popullore të Shqipërisë", Mësuesi, 14 qershor 1963:1

⁸ Hiqmet Bumci (N/drejtor i shkollës 7 vjeçare "Ptoleme Xhuvani" Elbasan), "Puna me problemet tip në fillore" Mësuesi 5 korrik 1963:2

Kuqan aktivitet kulturor-artistik në programin e të cilit natyrisht përfshihen dhe leksione me tematik politike.⁹

Ndërsa akoma më e thelluar na paraqitet politizimi i institucioneve arsimore në pranverën e vitit 1964 në rrethin e Librazhdit, (i cili është pjesë e Qarkut të Elbasanit) ku fillimisht brenda godinës së shkollës 11-vjeçare të qytetit të Librazhdit ngrihet dhoma e partisë. Ku vetë mësuesit nën drejtimin e institucioneve lokale të partisë e kompletojnë atë.¹⁰

Nga ana tjetër institucionet vendore përgjegjëse për arsimin dhe kulturën organizojnë në shkollën 11-vjeçare të Librazhdit një mbledhje me drejtorët e shkollave 7 e 8 vjeçare të rrethit që ata të njihen me dhomën e partisë dhe ata angazhohen që të realizojnë të njëjtën nismë në shkollat e drejtuar prej tyre. Si rezultat i kësaj nisme deri më 24 prill 1964 në rrethin e Librazhdit ishin ngritur 2 dhoma dhe 15 kënde partie, ndër të cilat vlerësohen për punë të mirë shkollat e Bërzeshtës, Prrenjasis dhe Hotolishtit.¹¹

Në këtë mënyrë jo vetëm që brenda godinave shkollore zënë vend hapësira të materialeve të propagandës politike të Partisë Punës, por edhe nëpërmjet gazetës “Mësuesi” pasqyrohet dhe propagandohet politizimi i institucioneve shkollore nga një shkollë fillimisht, më pas në një rreth dhe si qëllim final drejt gjithë vendit.

Në 4 korrik të vitit 1964 në qytetin e Elbasanit është hapur festivali i parë artistik i shkollave pedagogjike (shkollë e mesme që përgatit mësuesit e ardhshëm). Në këtë festival artistik pritet të marrin pjesë nxënës të shkollave pedagogjike të disa qyteteve të vendit, si nga Korça, Peshkopia, Berati, Tirana, Shkodra, Vlora dhe Gjirokastra.

⁹ Sulë Dedej (Korrespondenti ynë në Elbasan), “*E diela në Kuqan (shkolla pedagogjike merr në patronazh fshatin)*”, Mësuesi 6 dhjetor 1963:3

¹⁰ Qazim Gjini (Inspektor i seksionit të arsimit e kulturës – Librazhd), “*Dhomat e Partisë në shkolla*”, Mësuesi 24 prill 1964:1

¹¹ Qazim Gjini (Inspektor i seksionit të arsimit e kulturës – Librazhd), “*Dhomat e Partisë në shkolla*”, Mësuesi 24 prill 1964:1

Në shkollën 11-vjeçare “Qamil Guranjaku”, Elbasan, është ngritur një dhomë partie me material të pasur dhe interesant.¹²



Dhe nga këta nxënës-mësues të ardhshëm pritet që të shfaqin talentin e tyre artistik dhe së pari këtë ta dëshmojnë duke i kënduar Partisë së Punës, së cilës i detyrohen shumë.¹³¹³

S’ka hije dyshimi që në këtë mënyrë procesi i politizimit të arsimit dhe kulturës kishte hedhur rrënjë të thella në sistemin arsimor dhe kulturor në mesin e viteve ’60 pasi ishte një proces zinxhir i cili fillonte me nxënësin në bankat e shkollës i cili në të nesërmen e afërt do të ishte mësuesi i ardhshëm. Proces i cili vazhdimisht pasqyrohet dhe promovohet dhe nga gazeta “Mësuesi”.

Edhe në festivalin e dytë të shkollave pedagogjike të vitit 1965, nxënësit e shkollës pedagogjike “Luigj Gurakuqi” të Elbasanit, si pjesë e rëndësishme të repertorit të tyre artistik ka qenë ai për partinë dhe për sistemin socialist të vendosur në vend.¹⁴

Në vitin 1965 në fund të vitit shkollor në ambientet e shkollës 11-vjeçare “Tomorr Sinani” të Cërrikut është çelur një ekspozitë për herë

¹² Gazeta “Mësuesi”, “Në shkollën 11-vjeçare “Qamil Guranjaku”, Elbasan, është ngritur një dhomë partie me material të pasur dhe interesant”, Mësuesi 24 prill 1964:1

¹³ Korrespondenti i “Mësuesit” Elbasan, “Nesër hapat në Elbasan festivali artistik i shkollave pedagogjike”, Mësuesi 03 korrik 1964:1

¹⁴ Mehmet Arapi, “Për të nderuar emrin e Normales...”, Mësuesi 21 maj 1965:1

të parë. Në ekspozitë paraqiten punime dhe arritje të nxënësve të saj në disa fusha, por ajo që vlerësohet gjithashtu së tepërmi nga shkruesi i artikullit për gazetën "Mësuesi" është dhoma e partisë duke ja bashkangjitur asaj të vendlindjes, cilësohet si krenaria e mësuesve dhe e nxënësve të shkollës.¹⁵

Pra edhe në mesin e vitit 1965 vazhdon pasqyrimi, vlerësimi, promovimi nga gazeta "Mësuesi" të elementëve që politizojnë hapur veprimtarinë e institucioneve arsimore, sipas parimit që një shkollë bëhet shembull për të gjithë të tjerat.

Dhe në fillimin e vitit pasardhës kalendarik në fokus të shkrimeve të gazetës "Mësuesi" mbi aspektet politike në institucionet arsimore, merret shkolla "Tomorr Sinani" e qytetit të Cërrikut, tani 12-vjeçare (sipas ndryshimeve të reja në arsim) si shembull i një pune të veçantë në drejtim të përforcimit të edukimit politik të nxënësve. Por e veçanta e këtij viti dhe këtij artikulli është se nuk përmendet bashkërisht dhoma e vendlindjes me atë të partisë, por kjo e para trajton në të njëjtën mënyrë dhe të njëjtat tematika me atë të dytën.

Jo vetëm kaq, në këtë dhomë, ose më saktë do të ishte ta quajmë klasë, zhvillohen me nxënësit orë mësimi me tematik edukative, të cilat vlerësohen për një kontribut të çmuar në suazën e brumosjes me ide politike të nxënësve - *të cilat vlejné shumë për edukimin ideopolitik të nxënësve*.¹⁶

Në këtë mënyrë procesi i politizimit të institucioneve arsimore kalon në një stad më të thelluar dhe interaktiv nën një fasadë atdhedashurie e nostalgjie, ku kemi shkëmbimet në emërtim nga dhomë partie në dhomë vendlindje, ku qëllimi dhe detyrat që shtrohen në fushën e politizimit as ndryshohen e as reduktohen, përkundrazi ato intensifikohen e bëhen më aktive se kurrë duke e kthyer ambientin e krijuar edhe me përmbajtje më të theksuar politike nga një vend i veçantë brenda godinës së shkollës, tani në një klasë mësimi me të njëjtën përmbajtje, për të gjithë nxënësit e shkollës në

¹⁵ Hyjni Ceka, "Në katër sallat e një ekspozitë", Mësuesi 16 korrik 1965:3

¹⁶ Fatmir Shqerra (Mësues në shkollën 12-vjeçare "Tomorr Sinani" të Cërrikut), "Nuk e kemi si stoli, por ndihmëse në punën tonë", Mësuesi 14 janar 1966:3.

mënyrë të vazhdueshme. Në vendet që është vendosur regjimi komunist gjithë jeta e vendit ishte nën diktatin e partisë-shtet. Çdo gjë bëhej sipas planeve pesëvjeçarë, në këtë mënyrë të gjitha veprimtaritë në të gjitha fushat në vend ishin të organizuara, drejtuara dhe kontrolluara nga partia-shtet, pjesë e këtij plani ishin edhe institucionet arsimore dhe kulturore, por jo vetëm brenda këtyre institucioneve por edhe jashtë tyre dhe në fund të vitit shkollor. Në shkurt të vitit 1966 në përgjigje të planit të katërt pesëvjeçar maturantët e shkollës pedagogjike “Luigj Gurakuqi” të Elbasanit shprehin dëshirën e tyre që në fund të vitit shkollor, në pushimet e verës të shkojnë të punojnë në kuadrin e punës së dobishme shoqërore atje ku t’i udhëzojë partia: *ne të 208 maturantët e shkollës pedagogjike “Luigj Gurakuqi” të Elbasanit shfaqim dëshirën e zjarrtë, që, me të mbaruar studimet, të shkojmë për të punuar në fshat, kudo që do të na caktojë partia, atje ku ka më tepër nevojë Atdheu.*¹⁷

Kjo nismë e maturantëve nuk ngelet vetëm në aktin e një vendimmarrje, as në bërjen publike të saj nëpërmjet medias (gazetës “Mësuesi” në faqen e parë), por ata nëpërmjet shembullit të tyre u kërkojnë të gjithë nxënësve të tjerë të të njëjtit nivel në të gjithë vendin që t’u bashkohen në këtë iniciativë - *së bashku një hov të ri ndërtimit të socializmit në vendin tonë.*¹⁸

Përfundime

Vitet ‘60 e gjejnë Shqipërinë të konsoliduar nga pikëpamja ideologjike-politike, pikërisht nën frymën e marksizëm-leninizmit, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste me në krye liderin e saj Enver Hoxhën. Mirëpo kjo situatë dominuese politike shtetërore nuk ishte e mjaftueshme për drejtuesin e partisë së vetme në vend, ai kërkonte që gjithë jeta e vendit të politizohej. Për të arritur këtë objektiv një nga drejtimet kryesore në funksion të politizimit të jetës në vend, në terma

¹⁷ Maturantët e shkollës pedagogjike Elbasan, “208 maturantët e pedagogjikes së Elbasanit do të shkojnë ku të ketë nevojë Atdheu”, Mësuesi 18 shkurt 1966:1

¹⁸ Ibid.

afatmesëm dhe afatgjatë ishte padyshim politizimi i arsimit dhe kulturës.

Në këtë mënyrë institucionet arsimore dhe ato kulturore kthehen në qendra të propagandës dhe edukimit ideologjik. Dhe kjo veprimtari politike do të kryhej nga mësuesit dhe punonjësit e kulturës, të cilët janë nën trysinë e institucioneve vendore të partisë. Në shkollë brumosja me ideologjinë politike fillohej nga nxënësit e klasave më të ulëta deri tek ata të klasave më të larta. Si rrjedhojë politizohej jo vetëm e tashmja e vendit por edhe e ardhmja e tij. Procesi i politizimit të arsimit dhe të kulturës në vitet '60 në Qarkun e Elbasanit u shoqërua në çdo hap nga media, në rastin e studimit ishte gazeta "Mësuesi", e cila pasqyroi, promovoi dhe e amplifikoi atë, gjithashtu propagandoi edhe për media të tjera edhe më afër partisë-shtet në shërbim të politizimit.

Bibliografia

Gazeta "Mësuesi", Tiranë, 1961-1966.